




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË SHËRBIMIT SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR TË
KOSOVËS PËR VITIN 2023**

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 SHSKUK për shkak të vonesës në hartimin e specifikave teknike, për procedurën 'Pastrimi i hapësirave të brendshme të QKUK-së ka aplikuar procedurën e negociuar pa publikim;
- A2 Në specifikacionin teknik të kontratës "Furnizim me artikuj sanitarë dhe mirëmbajtje e pajisjeve" në nëntë raste ishin cekuar emrat e markave prodhuese;
- A3 Spitali i Përgjithshëm i Mitrovicës, mes pajisjeve tjera, kishte kryer pagesën edhe për pajisjen mjekësore "Sterilizator" e cila nuk ishte dorëzuar nga OE;
- A4 Në Spitalin e Prizrenit përkundër se figuronte në regjistrat e pasurisë, gjatë ekzaminimit fizik nuk kemi arrit të konfirmojmë ekzistencën e pasurisë "Kombi Bus - 4 dyer" ;
- B1 Në pesë (5) raste në vlerë 117,843€, kemi vërejtur që faturat e pranuar nuk ishin paguar me kohë. Vonesat ishin nga 10 deri në 319 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtor Financiar është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesues i Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e pasurisë dhe të shpenzimeve. Ky raport ka rezultuar me 11 rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, pesë (5) rekomandime të përsëritura dhe një (1) rekomandim pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim si rezultat i vonesës së hartimit të specifikave teknike

Gjetja

Neni 35 i LPP-së, Procedura e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, paragrafi 2 përcakton që: Autoriteti kontraktues mund të përdor procedurë të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien: 2.1. çfarëdo kontrate publike: (iii) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivist të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet në rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

Për procedurën e prokurimit “Pastrimi i hapësirave të brendshme të QKUK-së”, SHSKUK kishte vonuar nisjen e procedurave të prokurimit, ku si rezultat është detyruar të lidh kontratë me negociim për këto shërbime. Në planin e prokurimit, procedura për këtë kontratë ishte paraparë të fillonte në maj 2023 duke ditur se kontrata aktuale përfundonte me 29 tetor 2023. Mirëpo, deri në 4 tetor 2023, SHSKUK nuk kishte filluar me iniciimin e procedurës së rregullt të prokurimit për këtë kontratë. Duke e parë që procedura e rregullt nuk do të mund të përfundonte në kohë, SHSKUK më datë 27 tetor 2023 lidh kontratë tre mujore me negociim me OE paraprak në vlerë 462,902€ (bazuar në çmimet e kontratës paraprake). Në njoftimin e dërguar në KRRP për arsyetimin e procedurës së negociuar, potencohen arsyet e nevojës urgjente për kontraktimin e këtyre shërbimeve pasi që ishin vonuar me iniciimin e procedurave për kontratën e rregullt nga neglizhenca e personave përgjegjës për iniciim. Për më tepër, dy ditë pas lidhjes së kontratës së negociuar (29.10.2023), paraqitet një ankesë në OSHP nga OE për procedurën e rregullt, sinjal ky për vonesa të mëtejshme në këtë procedurë.

Shkak i përdorimit të kësaj procedure ishte neglizhenca e personave përgjegjës të njësisë kërkuese për iniciimin me kohë të procedurës së rregullt të prokurimit për kontratën përkatëse.

Ndikimi

Kontraktimi përmes procedurës së negociuar mund të ndikoj në zvogëlimin e konkurrencës dhe diskriminimin e ofruesve tjerë të shërbimeve të tilla, si dhe mund të rezultojë me një kosto më të lartë të shpenzimeve se sa çmimet e konkurrencës.

Rekomandimi A1

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se, për kontratat që dihet afati i përfundimit, të fillojnë me kohë procedurat e prokurimit, duke i pasur në konsideratë edhe kohën që mund të marrin ankesat e OE-ve apo pengesat tjera potenciale, në mënyrë që të shmangin lidhjen e kontratave të kësaj forme që janë në kundërshtim me rregullat e prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A2 - Aplikimi i kriterëve diskriminuese në specifikacionin teknik**

Gjetja Sipas nenit 28 të LPP-së paragrafi 2, Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Në kontratën "Furnizim me artikuj sanitarë dhe mirëmbajtje e pajisjeve" në vlerë 14,623€, njësia kërkuese në Qendrën e Shëndetit Mendor Gjilan në hartimin e specifikacionit teknik, në nëntë (9) artikuj kishte cekur emrat e markave prodhuese duke favorizuar kështu operatorë ekonomik të caktuar.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së njohurive nga njësia kërkuese gjatë hartimit të specifikave dhe mungesës së kontrolleve nga zyrtarët e prokurimit për të parandaluar këtë devijim.

Ndikimi Vendosja e kriterëve favorizuese në specifikime teknike shkakton trajtim jo të barabartë apo diskriminimin e operatorëve ekonomik dhe dëmton konkurrencën.

Rekomandimi A2 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë kontrolle efektive tek njësitë kërkuese dhe në zyrën e prokurimit me qëllim që të evitohet përdorimi i kriterëve favorizuese me rastin e hartimit të specifikave teknike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Kryerja e pagesës për pajisjen që nuk është dorëzuar nga OE**

Gjetja Neni 23 paragrafi 3 i rregullës financiare Nr.01/2013 /MF - Shpenzimi i parave publike specifikon që: Zyrtari / komisioni i autorizuar për pranimin e mallrave/shërbimeve të zbatoj dispozitat e parapara me rregullat për menaxhimin e pasurisë qeveritare. Për më shumë, neni 8 paragrafi 4 i rregullores MF - Nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare - specifikon që: Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare që ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar dhe të dokumentuar me procesverbal që janë në përputhje me kontratën apo urdhër blerjen.

Më datë 18.12.2023, Drejtori i Spitalit të Përgjithshëm të Mitrovicës kishte themeluar komisionin për pranimin e pajisjeve mjekësore sipas kontratës "Furnizim me pajisje mjekësore - Lot IV". Sipas raportit të pranimit të hartuar dhe nënshkruar nga ky komision të gjitha pajisjet janë pranuar në bazë të kriterëve dhe kushteve të kontratës.

Gjatë ekzaminimit fizik të këtyre pajisjeve kemi konstatuar se pajisja "Sterilizator" e paguar në vlerë 1,500€, nuk ishte dorëzuar fare në Spital. Mos dorëzimi i kësaj pajisje është vërtetuar edhe nga procesverbali i

mbajtur nga ekipi i auditimit i cili është nënshkruar nga dy anëtarët e komisionit të pranimit dhe Zëvendës Drejtorit të Spitalit, ku pohojnë se pajisja nuk ka ardhur asnjëherë në spital.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së përgjegjësisë nga ana e komisionit të pranimit të pajisjeve mjekësore duke e nënshkruar raportin e pranimit pa verifikim fizik të këtyre pajisjeve.

Ndikimi Shpenzimet për pajisjen e papranuar dëmtojnë buxhetin e spitalit dhe ndikojnë në mos përmbushjen e nevojave për të cilat shërben ajo pajisje dhe rrjedhimisht pamundësojnë arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi A3 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcojnë kontrollet e brendshme dhe të sigurohen se para ekzekutimit të çdo pagese janë pranuar pajisjet sipas kontratës, me qëllim që të arrihet qëllimi për të cilin është shpenzuar paraja publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mungesa e pasurisë

Gjetja Sipas nenit 8 të Rregullores MF - NR. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare - Pranimi i pasurisë jo financiare bëhet nga blerja, ndërtimi, dhurimet dhe transferet nga organizatat tjera buxhetore.

Gjatë ekzaminimit fizik të pasurisë në Spitalin e Prizrenit, nuk kemi arrit të konfirmojmë ekzistencën e pasurisë "Kombi Bus - 4 dyer" në vlerë origjinale prej 25,000€. Pasuria në fjalë mungonte dhe nuk kishte informata/dokumentacion që tregon se pasuria është në përdorim të spitalit, është tjetërsuar apo dhuruar.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së përgjegjësisë nga ana e zyrtarëve përgjegjës të Spitalit të Prizrenit për ofrimin e informatave të pasurisë që mbajnë në regjistra dhe identifikimin fizik të saj.

Ndikimi Pa mundësia për të dëshmuar ekzistencën fizike të pasurisë të cilën e mban në regjistra, në mungesë të informatave për të njëjtën, rritë mundësinë e keqpërdorimit të pasurisë, humbjes apo tjetërsimit.

Rekomandimi A4 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë ashtu që të sigurojnë informata dhe dëshmi për ekzistencën fizike për të gjitha pasuritë e mbajtura në regjistra, në mënyrë që të evitohet mundësia e humbjes apo keqpërdorimit të pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Neni 39.1 i LMFPP përcakton që: ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në pesë (5) raste në vlerë 117,843€, kemi vërejtur që faturat e pranuar nuk ishin paguar me kohë. Vonesat ishin nga 10 ditë deri në 319 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Në një rast fatura e pranuar nuk ishte paguar për shkak të përfundimit të kontratës, deri sa në rastet tjera kjo kishte ndodhur si rezultat i pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës për pagesën me kohë të faturave të pranuar.

Ndikimi Tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund ta bëjë SHSKUK-në subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi B1 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda 30 ditëve pas pranimit të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim është çështja që ka të bëjë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja B2 - Nënvlërësimi i pasurisë kapitale në PFV

Gjetja

Neni 6.3 i rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, specifikon se "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Tutje, neni 10, parasheh që "Të gjitha pasuritë jo financiare pas pranimit në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore, pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara, duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël dhe të jenë objekt i inventarizimit dhe i vlerësimit". Ndërsa, sipas nenit 22 të rregullores së njëjtë, përcaktohet metoda e zhvlerësimit të pasurive, norma si dhe llogaritja bazuar në natyrën e pasurisë .

Vlera e pasurisë e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 106,519€. Në këtë kishte ndikuar nënvlerësimi i pasurisë kapitale për 1,444,914€ për shkak të mos regjistrimit të blerjeve të pasurisë, përderisa në anën tjetër ishte mbivlerësuar për 1,338,395€ si rezultat i gabimeve në zhvlerësim. Opinioni i auditimit nuk është modifikuar për këtë çështje për shkak se gabimi i identifikuar nuk është material në nivel të PFV-ve. Parregullsitë e identifikuara janë si në vijim:

- Nënvlërësimi i pasurive ishte shkaktuar nga: mos regjistrimi i pasurive të blera gjatë vitit 2022 dhe 2023 në vlerë 1,164,134€ nga ana e Spitalit të Prizrenit; pajisjes në vlerë 34,181€ të blerë nga Administrata e SHSKUK-së; pesë pajisjeve stomatologjike në vlerë prej 73,980€ të blera nga QSKUK; aparatúra në vlerë 89,747€ e blerë nga Spitali i Mitrovicës; pajisjet speciale mjekësore në vlerë 38,408€ dhe furnizimet mjekësore në vlerë 35,055€ të blera nga Spitali i Pejës; një rast i regjistrimit gabim prej 1,596€ të trotuarit nga ana e QKUK-së; si dhe një rast i aplikimit gabim të zhvlerësimit prej 7,813€;
- Mbivlerësimi i pasurisë kishte rezultuar pasi që: në pesë (5) pajisje mjekësore me jetëgjatësi prej pesë viteve dhe në dy (2) automjete transporti me jetëgjatësi prej shtatë viteve, nuk ishte aplikuar zhvlerësimi fare; si dhe në gjashtë (6) pajisje mjekësore ishin aplikuar norma të gabuara të zhvlerësimit për shkak të kategorizimit jo të drejtë në klasën e pasurisë.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontroleve të cilat nuk kanë arritur me i identifikuar dhe parandaluar devijimet e tilla. Vlen të përmendet se sa i përket pajisjes mjekësore në vlerë 35,055€, deri sa ishim ne në auditim, Spitali i Pejës kishte ndërmarrë veprime për regjistrimin e kësaj pasurie. Kjo do të verifikohet nga ekipi i auditimit për vitin 2024.

Ndikimi

Mos regjistrimi i blerjeve dhe gabimet në zhvlerësimin e pasurisë kanë ndikuar në nënvlerësim të vlerës së përgjithshme të pasurisë në PVF, duke

shkaktuar prezantim jo të drejtë dhe të vërtetë të informatave në PVF.

Rekomandimi B2 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që pasuria kapitale të regjistrohet në vlerën e saktë, në mënyrë që raportimi i tyre në PFV të jetë i drejtë dhe i vërtetë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Pasaktësi në prezantimin e informatave në PFV

Gjetja Sipas nenit 17 të Rregullores MF -Nr.01/2017 për raportim vjetor të OB-ve, organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Ne identifikuam se në raportin e përgjithshëm të obligimeve në PFV-të e SHSKUK-së nuk janë prezantuar obligimet në vlerë prej 29,136€. Nga kjo vlerë, obligimet prej 3,466€ i takonin Spitalit të Gjilanit, ndërsa 25,670€ Spitalit të Gjakovës.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kujdesit të duhur gjatë përgatitjes së Pasqyrave Financiare të SHSKUK-së.

Ndikimi Kontrollet e dobëta gjatë konsolidimit të pasqyrave kanë ndikuar në prezantimin jo të drejtë të obligimeve në PFV.

Rekomandimi C1 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë kontrolle më të forta në përgatitjen dhe konsolidimin e të dhënave në PFV, në mënyrë që ato të prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2023 ishte 64,518,781€, prej tyre ishin shpenzuar 62,944,876€. Këto kishin të bënin me furnizime mjekësore, furnizime me ushqim dhe pije për spitale, mirëmbajtje të objekteve shëndetësore, mirëmbajtje të pajisjeve, etj.

Çështja A5 - Tejkallim i kontratës kornizë me çmim për njësi

Gjetja Bazuar në Rregulloren nr.001/2022 për prokurimin publik, neni 17.35 Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në baze të poentimit. Si rrjedhojë, peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit. Menaxheri i kontratës mbetet përgjegjës që të dëshmoj në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK.

Në kontratën kornizë me çmime për njësi "Servisimi dhe Mirëmbajtja e Impanit të mbetjeve Spitalore Tipi Ecodus T-300" me vlerë të parashikuar 14,000€, Spitali i Gjilanit, ka tejkalluar vlerën e lejuar për shpenzim sipas peshimit. Vlera totale e tejkallimit të kontratës ishte 3,776€, prej tyre 310€ ishin paguar, ndërsa pjesa tjetër prej 3,466€, ishin raportuar si obligime të papaguara.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes së dobët nga ana menaxherit të kontratës.

Ndikimi Tejkallimi i vlerës së kategorive sipas peshimit, ndikon në mungesë të transparencës për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Kjo po ashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore.

Rekomandimi A5 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë përmes njësive kërkuese dhe departamentit të prokurimit, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luajnë një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale të spitalit, në mënyrë që këto kontratat të realizohen në pajtueshmëri të plotë me peshat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 paragrafit 3 të rregullës financiare nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të realizohen dhe të evidentohen në kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i Udhëzimit Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël kërkon nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

SHSKUK gjatë vitit 2023, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve (kodi i mirëmbajtjes) ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 140,326€ të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë së investimeve kapitale, si në vijim:

- Kontrata “Mirëmbajtja dhe renovimi i objektit të Qendrave të Shëndetit Mendor në Prishtinë (QSHM) -Mitrovicë” në vlerë 14,444€, kishte të bënte me renovim të objekteve; dhe
- Kontrata ‘Renovim i objekteve në QSHM Prishtinë, QSHM Podujevë, Shtëpia për Integrim (SHI) Drenas dhe SHI Fushë Kosovë” në vlerë 125,882€ (përfshirë 30%).

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së një analize të natyrës së shpenzimeve nga ana e zyrtarit autorizues (mbajtësi i buxhetit) me rastin e planifikimeve buxhetore.

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kodet joadekuate të shpenzimeve kanë ndikuar në mbivlerësimin e njëres komponentë dhe nënvlerësimin e komponentës tjetër dhe për efekt kanë paraqitjen jo të saktë dhe jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi B3

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se me rastin e planifikimit të projekteve, bëhet një analizë e mirëfilltë e natyrës së shpenzimeve në mënyrë që projektet të buxhetohen në përputhje me natyrën e shpenzimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 239,044,813€, pasurive jokapitale 6,143,943€, si dhe e stoqeve 8,476,443€.

Çështja B4 - Mos-inventarizimi i plotë i pasurisë

Gjetja

Sipas Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, neni 19, Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ i organizatës buxhetore. Përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare ndër të tjera janë: inventarizimi i të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore; verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare; dhe krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Në Spitalin e Mitrovicës dhe Ferizajt ishin formuar komisionet për inventarizimin e pasurisë, mirëpo të njëjtat nuk e kishin kryer inventarizimin e pasurisë sipas kërkesave të rregullores përkatëse, pasi që nuk i kishin përfshirë të gjitha pasuritë që këto spitale i kanë në përdorim. Kjo ka pamundësuar harmonizimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare në këto spitale.

Kjo kishte ndodhur për shkak se në Spitalin e Mitrovicës, komisionit nuk i ishte lejuar numërimi fizik nga ana e punonjësve në disa nga zyrat e Spitalit, derisa në Spitalin e Ferizajt, komisionet në 12 reparte nuk e kishin bërë fare inventarizimin.

Ndikimi

Mos kryerja e inventarizimit sipas kërkesave të rregullores përkatëse mund të ndikojë në mos raportimin e saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive në PFV.

Rekomandimi B4

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se kryhet procesi i inventarizimit të pasurisë sipas kërkesave të rregullores në fuqi në mënyrë që të kemi një raportim të saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Funksionimi jo i plotë i sistemit e-pasuria

Gjetja

Sipas nenit 6.3 të rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

SHSKUK, as gjatë vitit 2023, nuk kishte arritur funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria. Të dhënat e raportuara në PFV për pasuritë nën 1,000€ ishin marrë nga data bazat e brendshme që mbahen në Excel nga ana e njësive në kuadër të SHSKUK-së.

Përdorimi i sistemit të e-pasurisë nuk ishte i njëjtë në të gjitha spitalet, disa spitale kishin filluar me regjistrim të pasurisë në këtë sistem, disa ishin në fazën e migrimit të të dhënave të viteve të kaluara, e disa të tjera ishin në

fazën e trajnimit të stafit.

Mos funksionalizimi i plotë i sistemit e-pasuria, ishte rezultat i mungesës së veprimeve të nevojshme dhe në kohët nga ana e SHSKUK-së.

Ndikimi

Mbajtja manuale e të dhënave rrit mundësinë e gabimeve në mirëmbajtjen e regjistrave, shlyerjeve potenciale, keqpërdorimit, humbjes apo të tjetërsimit tyre.

Rekomandimi B5

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të marrin të gjitha veprimet e nevojshme për funksionalizimin e plotë të sistemit të e-pasurisë dhe i njëjti të jetë bazë për raportimin e pasurisë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁸	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	139,665,909	157,090,004	154,716,693	129,066,604	135,267,328
Grante Qeveritare - Buxheti	139,665,909	150,367,831	148,110,128	123,580,480	133,865,860
Financimi përmes huamarrjes	0	6,606,665	6,605,585	5,465,547	1,367,255
Donacionet vendore	0	113	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	115,395	980	20,577	34,213

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 17,312,121€. Kjo rritje ishte rezultat i rritjes në grantit qeveritar prej 10,701,922€ për shkak të ndikimit të ligjit të pagave, financimit nga huamarrja 6,606,665€ dhe donacioneve 3,534€.

Në vitin 2023 SHSKUK ka shpenzuar 99% të buxhetit përfundimtar ose 154,716,693€ me një përmirësim prej 6% në krahasim me vitin 2022.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	139,665,909	157,090,004	154,716,693	129,066,604	135,267,328
Pagat dhe mëditjet	63,071,047	84,535,559	84,532,481	70,231,105	73,820,177
Mallrat dhe shërbimet	59,006,346	60,239,765	58,769,656	49,576,205	48,653,315
Komunalitë	3,639,016	4,279,016	4,175,220	3,542,744	3,586,553
Investimet Kapitale	13,949,500	8,035,664	7,239,337	5,716,550	9,207,283

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 21,464,512€, rritje kjo si rezultat i ndryshimit të ligjit të pagave për zyrtar publik . Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,233,419€. Realizimi i kësaj kategorie ishte 98%.
- Buxheti final për komunalitet, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 640,000€. Realizimi i kësaj kategorie ishte 98%.
- Buxheti final për investime kapitale, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 6,025,810€, si rezultat i shkurtimeve buxhetore në fund të vitit. Nga 26 projektet e planifikuara, tri nga këto nuk kanë realizuar asnjë shpenzim, dhe se kjo kishte ndikuar në shkurtime buxhetore. Projektet e perealizuara janë: "Ndërtimi i objektit për klinikën Hemato-onkologjike" dhe "Projektimi dhe ndërtimi i ndërtesës së re së Klinikës së Nefrologjisë" të cilat nuk kanë mundur të realizohen për shkak se lëndët kanë qenë në OSHP në periudhë mbi gjashtë muaj, ndërsa projekti "Ndërtimi ndërtesës së re të QSKUK"- për shkak të problemeve me hapësirën në të cilën ishte paraparë ky ndërtim. Përderisa, projekti "Ndërtimi i objektit për themelimin e laboratorit për kateter" nuk ishte i planifikuar me buxhetin e vitit 2023, i njëjti ishte realizuar nga mjetet e marra të projekteve tjera dhe kishte të bënte me punë shtesë të pa parashikuara që kishin rezultuar tek një projekt i vitit 2022. Realizimi i kësaj kategorie ishte 91%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga SHSKUK për vitin 2023 ishin më të larta se të hyrat e planifikuara për 689,472€, apo 22% Ato kanë të bëjnë me të hyra nga participimet, të hyrat nga taksa për parkim publik, të hyrat nga taksa si certifikatë mjekësore, etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	3,070,443	3,070,443	3,759,915	3,230,451	2,645,850
Të hyrat jo tatimore	3,070,443	3,070,443	3,759,915	3,230,451	2,645,850

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të SHSKUK ka rezultuar në 10 rekomandime. SHSKUK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, tri (3) rekomandime janë zbatuar, një (1) rekomandim ishte zbatuar pjesërisht, pesë (5) rekomandime nuk ka filluar zbatimin dhe një (1) rekomandim është mbyllur, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Krahasuar me vitin e kaluar gjendja e implementimit të rekomandimeve mbetet e njëjtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë kontrolle më të forta në përgatitjen dhe konsolidimin e të dhënave në PFV, në mënyrë që ato të prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë.	Gjatë analizimit të PVF-ve kemi vërejtur se edhe këtë vit PFV nuk ishin të sakta pasi që obligimet ishin nënvlerësuar.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Pagat dhe mëditjet	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojnë se kontratat e punës zbatohen në pajtim të plotë me Statutin e QKUK-së.	Në auditimin e vitit 2023 nuk ka rezultuar kjo çështje.	I zbatuar

3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se me rastin e planifikimit të projekteve, bëhet një analizë e mirëfilltë e natyrës së shpenzimeve dhe ashtu që projektet të buxhetohen në përputhje me natyrën e shpenzimit.	SHSKUK edhe gjatë vitit 2023 kishte raste të keqklasifikimit të shpenzimeve	Nuk ka filluar zbatimimi
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcoj kontrollet e brendshme, dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin e procedurave, duke filluar nga iniciimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.	Në auditimin e vitit 2023 nuk ka rezultuar kjo çështje.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë përpilimin e raporteve dhe planeve të menaxhimit të kontratës nga ana e menaxhereve në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kontratave sipas kriterëve të parapara.	Në auditimin e vitit 2023 nuk ka rezultuar kjo çështje.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që pasuria kapitale të regjistrohet në vlerën e saktë, në mënyrë që raportimi i tyre në PFV të jetë i drejtë dhe i vërtetë.	Gjatë testimit kemi vërejtur se edhe gjatë vitit 2023 ka nënvlerësim të regjistrimit të pasurisë.	Nuk ka filluar zbatimimi
7.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se pas kryerjes së procesit të inventarizimit, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të bëhet krahasimi në mes të gjendjes së inventarizuar dhe regjistrave të pasurisë në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV.	Në Spitalin e Mitrovicës dhe në Spitalin e Ferizajt nuk ishte kryer inventarizimi i përgjithshëm i pasurisë dhe si rezultat nuk është bërë edhe harmonizimi i pasurisë.	Nuk ka filluar zbatimimi
8.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-pasuria.	Edhe gjatë vitit 2023 kishte probleme në përdorimin e sistemit e-pasuria.	Nuk ka filluar zbatimimi
9.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të aplikojë një analizë të mirëfilltë të regjistrimit të pasurive për të siguruar se ato janë kategorizuar drejtë, në mënyrë që gjendja e bartur në vitin vijues të ofrojë informata të drejta dhe të vërteta në PFV.	Ky rekomandim është fuzionuar tek rekomandimi që lidhet me çështjen B2 Nënvlerësimi i pasurisë kapitale	Nuk është i aplikueshëm më
10.	Obligimet e papaguara	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturave.	Edhe gjatë vitit 2023 ka pasur raste ku faturat e pranuar nuk ishin paguar me kohë.	Nuk ka filluar zbatimimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Burbuqe Idrizi, Udhëheqëse e ekipit




Jehona Krasniqi, Anëtare e ekipit



Mimoza Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Bolnička i Klinička Univerziteteska Sluzba Kosova (BKUSK)
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për vitin 2023");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe (kjo pikë përshtatet nga entiteti)
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Elvir Azizi
Drejtor i SHSKUK-së,
Data: 20.05.2024, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹⁰, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Furnizim mjekësor në vlerë prej 21,480€ në QKUK; mirëmbajtje dhe servisim në vlerë 40,045€ në QKUK; objektet shëndetësore në vlerë 27,182€ në QKUK; furnizim me inventar medicinal dhe administrativ në vlerë 25,670€ në Spitalin e Gjakovës; servisim dhe mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore në vlerë 3,466€ në Spitalin e Gjilanit.
- ⁶ Pesë pajisje mjekësore (binocular optikal led microscope for pathol, lights,surgical, tables oprating, transport icubator-special care , servisim i aparatit të anestezionit: Fabius CE) me jetëgjatësi prej pesë vite, një automjet transporti dhe një kombi bus-4 dyer-i bardh me jetëgjatësi prej shtatë viteve, nuk ju kishte aplikuar zhvlerësimi fare (vlera e gabimit 69,030€); katër pajisje mjekësore (CT/e Kompjuterizuar/Somatom/, Rezonanc magnetike, RTG dig-AXIOM Aris.VXkomp dhe CT Emotion 6 shtresor Siemens) me jetëgjatësi prej pesë vite, ishin kategorizuar si ndërtesa dhe struktura tjera me jetëgjatësi prej 40 vite (vlera e gabimit 1,254,314€); pajisja Piruner Dizel 3Ton me jetëgjatësi prej shtatë viteve ishte kategorizuar si telefona fiks me jetëgjatësi prej tetë vite vlera (vlera e gabimit 91€); si dhe pajisja mjekësore Multi Energy Lineae Accelerator për Klinikën e Onkologjisë në Radioterapi me jetëgjatësi prej pesë viteve ishte kategorizuar si pajisjet tjera me jetëgjatësi prej gjashtë viteve (vlera e gabimit 14,960€);
- ⁷ Detajet e peshimit të kontratës: kategoria C e specifikave është peshuar me 25% të kontratës apo lejim të shpenzimit deri në vlerë 3,500€, ndërsa ishte realizuar në vlerë 7,970€ apo 57% e vlerës së kontratës; kategoria B e specifikave është peshuar me 35% të kontratës apo lejim të shpenzimit deri në vlerë 4,900€, ndërsa ishte realizuar në vlerë 4,160€ apo 30% e vlerës se kontratës; përderisa kategoria A e specifikave është peshuar me 40% të kontratës apo lejim të shpenzimit deri në vlerë 5,600€, ndërsa ishte realizuar në vlerë 5,640€.
- ⁸ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁰ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.